



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KRYETARI

Nr. 134 prot

Gramsh, me 02/04/2025

VENDIM

Nr. 27, datë 02/04/2025

PËR
CAKTIMIN E VENDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 dhe nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per veteqeverisjen vendore"; nenit 79 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar); Udhëzimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Nr.6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", me qëllim përcaktimin e rregullave për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës zgjedhore; Shkresës Nr.2210 prot, datë 27.03.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Mbi përcaktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore"

VENDOSA:

1. Materialet propagandistike të cilat do të përdoren nga subjektet lejohen të afishohen në një distance deri në 5 (pesë) metra larg zyrës zgjedhore të partisë apo subjektit zgjedhor përkatës.
Vendi publik që do të kene në dispozicion subjektet zgjedhore për afishimin e materialeve propagandistike, të vendosura në stenda provizore të çmontueshme, do të jetë sheshi tek "Antonio Gramsci", Bl."10 Korriku" në veri te fushës sportive.
Me mbarimin e fushatës zgjedhore, subjektet zgjedhore të marrin masat për heqjen e të gjithë materialeve propagandistike.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.).
3. Të merren masa për të mos lejuar dhe për të hequr menjëherë çdo material statik, përfshirë posterat dhe flamujt nga çdo vendndodhje tjetër ku ato konstatohen që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij vendimi.
4. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik
5. Caktimin e sheshit "Kamber Dërmyshi" si vend për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore dhe informuese në dispozicion të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar.

6. Zyrrat zgjedhore të subjekteve zgjedhorë mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-së, QV-ve dhe VNV-së. Të bëhet verifikimi i vendndodhjes së zyrrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të Udhëzimit Nr.6, datë 23.03.2021 për afishimin e materialeve propagandistike.
7. Subjektet zgjedhore të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Bashkisë dhe të bëjnë me dije KQZ-në për hapjen e zyrrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre.
8. Administrata e bashkisë, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, të bëjë verifikimin e vendndodhjes së zyrrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të udhëzimit për afishimin e materialeve propagandistike
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtorja e Menaxhimit të Territorit, Shërbimeve Publike dhe Mirmbajtjes në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, Koordinatorin për të drejtën e informimit për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të bashkisë, si dhe një kopje t'i dërgohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Komisarariatit të Policisë Gramsh.
10. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Besion AJAZI

